
	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fage 1 nga 15</i>


Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri i Kompanisë	KOSTT	KOSTT	ZRrE
Data	28.02.2011	28.02.2011	28.01.2011

..... **PERMBAJTJA**

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 2 nga 15</i>

1	Hyrje.....	3
2	Definicionet	4
2.1	Të përgjithshme	Error! Bookmark not defined.
2.1.2	Sistemi i Transmisionit të Kosovës.....	4
2.1.3	Kushtet Normale të Sistemit	4
2.1.4	Kushtet e Ndërprerjes së Planifikuar	5
2.1.5	Linja Error! Bookmark not defined.	
2.1.6	Kriteri ‘N-1’	5
2.1.7	Kriteri ‘N-1’ nën kushtet e ndërprerjes së planifikuar.....	5
2.1.8	Kushti i Tensionit të Papranueshëm	5
2.1.9	Ndryshimi i Shpejtë i Tensionit.....	6
2.1.10	Ndryshimi i Papranueshëm i Shpejtë i Tensionit.....	6
2.1.11	Mbingarkimi i Papranueshëm i Pajisjeve.....	6
2.2	Informata të Përgjithshme.....	6
3	Planifikimi i rezervave të Sistemit të Transmisionit të Kosovës.....	7
3.1	Politika e Përgjithshme	7
3.2	Kriteret e Planifikimit – Sistemet 400 kV dhe 220 kV	7
3.2.1	Sistemi 400 kV dhe 220 kV	7
3.2.2	Kriteret e planifikimit nën Kushtet Normale të Sistemit.....	8
3.2.3	Kriteret e Planifikimit nën Kushtet e Ndaljes së Planifikuar	8
3.3	Kriteret e Planifikimit – Sistemi 110 kV	9
3.3.1	Sistemi 110 kV.....	9
3.3.2	Kriteret e planifikimit nën Kushtet Normale të Sistemit.....	10
3.3.3	Kriteret e Planifikimit nën Kushtet e Ndërprerjes së Planifikuar.....	11
3.4	Pa-mundësia për të përmbushur Kriterin ‘N-1’	11
4	Planifikimi i nivelit të Lidhjes së Shkurtë të Sistemit të Transmisionit të Kosovës.....	12
5	Stabiliteti i përkohshëm dhe dinamik i sistemit të transmisionit të Kosovës	12
6	Kualiteti i Tensionit në Sistemin e Transmisionit të Kosovës.....	13

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 3 nga 15</i>

7	Kushtet e Përgjithshme	13
7.1	Procedura e Kontesteve	13
7.2	Ndryshimet në Standardet e Planifikimit të Transmisionit.....	13
7.3	Rrethanat e Paparashikuara.....	13
8	Shtojca 1 – Derogime nga Standardet e Planifikimit	15
9	Burimet dhe Dokumentet.....	15

1 Hyrje

1.1 Ky dokument është përpiluar sipas Nenit 15 – **Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit** të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit.. Duhet të lexohet në lidhje me **Kodin e Rrjetit** dhe me **Standardet e Sigurisë së Operimit**.

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 4 nga 15</i>

1.2 Ky dokument përcakton një varg kriteresh dhe metodologjish të cilat **OST** duhet t'i aplikoj në planifikimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës zhvillimin e **sistemit të transmisionit**. Këto përfshijnë teknikat e kostos-benefitit dhe bashkëpunimin me sistemet interkonektive.

1.3 Kriteret dhe metodologjitë në këtë dokument do të aplikohen në planifikimin e zhvillimit të transmisionit. Kjo do të thotë se kriteret dhe metodologjitë zakonisht aplikohen në situatat të cilat janë deri 10 vjet përpara.

1.4 Rezultatet e metodologjive të përshkruara në këtë dokument duhet të raportohen nga **OST** në **Planin zhvillimor të transmisionit**. Konkluzionet duhet të shprijnë në masat lehtësuese si investimi në rrjetë.

2 Definicionet

Në këtë dokument termet e definuara kanë kuptimin si në Dispozitat e përgjithshme (Përcaktimi i Termave) të **Kodit të Rrjetit**, përveç atyre që janë definuar më poshtë.


2.1 Sistemi i Transmisionit

Sistemi i Transmisionit të Kosovës përbëhet nga:

- (a) Linjat 400 , 220 dhe 110 kV, transformatorët 400/220 kV, 400/110 kV , 220/110kV, transformatorët 220/35/10kV, 110/35 kV, 110/35/10(20)kV, 110/10(20)kV si dhe stabilimentet dhe pajisjet e ndërlidhura, brenda Kosovës të cilat janë në pronësi të **KOSTT**;
- (b) Zbarrat 110 kV dhe ndërprerësit e linjave 110 kV si dhe stabilimentet dhe pajisjet e ndërlidhura në NS Sharri;
- (c) Zbarrat 110 kV, përfshirë zbarrat e dyfishta me fushën lidhëse dhe ndërprerësit e linjave 110kV dhe stabilimentet dhe pajisjet e ndërlidhura në NS Trepça;

2.2 Kushtet normale të sistemit

Situata kur **sistemi i transmisionit** të Kosovës operohet sipas planifikimit të punës së sistemit, pa **ndërprerje** të paplanifikuara në sistem.

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 5 nga 15</i>

2.3 Kushtet e ndërprerjes së planifikuar

Situata kur **sistemi i transmisionit** të Kosovës operohet me një apo më shumë ndërprerje të planifikuara.

2.4 Qarku

Qarku është ajo pjesë e sistemit ndërmjet dy ose më shumë ndërprerësve të përfshirë. Mund të përfshijë transformatorë, , kablllo nëntokësore dhe linja. Shant reaktorët dhe kompenzatorët si dhe zbarrat nuk konsiderohen si **qarqe**.

2.5 Kriteri 'N-1'

Kriteri 'N-1' është rregull sipas të cilit sistemi me elementet e mbetura në operim pas dështimit të një elementi të vetëm të rrjetit (si psh. një linjë e transmisionit, transformator, njësi gjeneruese, ose seksion i caktuar i zbarrave) sistemi duhet të jetë në gjendje të akomodoj ndryshimin e rrjedhave të fuqisë në rrjet të shkaktuara nga ai dështim i vetëm.


2.6 Kriteri 'N-1' nën kushtet e ndërprerjes së planifikuar

Kriteri 'N-1' në kohën kur një element tjetër i rrjetit nuk është në dispozicion për shkak të një ndërprerje të planifikuar. Sistemi duhet të jetë në gjendje të akomodoj ndryshimin e rrjedhave në rrjetë të shkaktuara nga një prishje e vetme. Duhet të theksohet se ngarkesat e parashikuara, gjenerimi, programet e importit dhe eksportit duhet të mirren parasysh gjatë periudhave të mirëmbajtjes.

2.7 Kufijtë e pa-pranueshëm tensionit të

2.7.1 Tensioni jashtë kufijve për rrethanat normale ose rrethana të jashtëzakonshme, siç specifikohet në paragrafin 3.4.2 të **Kodit të Balancit të Kodit të Rrjetit**.

2.7.2 Është e pranueshme që pas ndryshimit të shpejtë të tensionit, tensioni të jetë jashtë kufijve normal siç specifikohet në **kodin e balancit të Kodit të Rrjetit**, nëse mund të ndërmerren veprime automatike dhe manuale për të rikthyer tensionin brenda 10 minutave brenda kufijve normal.

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 6 nga 15</i>

2.8 Ndryshimi i shpejtë i tensionit

Ndryshimi i tensionit i shfaqur në nënstacionin e transmisionit rreth një sekondë pas një ndërprerje, pas cilitdo çrregullim të rëndë për shkak të një prishje është stabilizuar pas veprimit të cilitdo rregullator të tensionit të gjeneratorit.

2.9 Ndryshimi i papranueshëm i shpejtë i tensionit

Çdo **ndryshim i shpejtë i tensionit** pas një prishje ose ngjarje tjetër të rëndësishme i cili tejkalon 10% të tensionit të gjendjes së qëndrueshme para prishjes.

2.10 Mbingarkimi i papranueshëm i pajisjeve

2.10.1 Mbingarkimi i cilësdo pjesë të pajisjeve elektrike përtej kapacitetit të specifikuar për kohën e caktuar.


2.10.2 Mbingarkimi i stabilimenteve lejohet për aq gjatë sa është e specifikuar t dhe ku mbingarkesa mund të shkarkohet me ndaljen manuale brenda kohës së lejuar.

2.10.3 Në rast se **sistemi i transmisionit** është në pajtueshmëri me standardet dhe nëse aplikohet kapaciteti i mbingarkimit afatshkurtër të pajisjes, **OST** detajon veprimet e nevojshme në **Planin zhvillimor të transmisionit**.

2.11 Informata të përgjithshme

Përveç kuptimeve të veçanta të detajuara më lartë, fjalët dhe frazat e caktuara më lartë kanë kuptimet vijuese:

- Referenca në gjininë mashkullore përfshijnë atë femërore dhe referencat në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe *anasjelltas*,
- Përveç ku thuhet ndryshe në mënyrë eksplicite të gjitha referencat në seksion do të jenë referencat në një seksion në këtë dokument,
- Cilado referencë në një ligj ose rregullore duhet të jetë referencë në atë ligj ose rregullore të aplikueshme në Kosovë, ose pas zëvendësimit të atij ligji apo rregullore do të jetë ligji ose rregullorja e re nga data e hyrjes në fuqi.

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 7 nga 15</i>

3 Planifikimi i kontigjencave të Sistemit të Transmisionit

3.1 Rregulla të përgjithshme

3.1.1 Në parim **sistemi i transmisionit** të Kosovës do të planifikohet për operim gjatë tërë kohës për të përmbushur **kriterin 'N-1'**. Sidoqoftë, në disa situata ku nuk është efektive që gjatë tërë kohës të përmbushet **kriteri 'N-1'**, aplikohen përjashtime. Këto përjashtime janë ose të përshkruara në mënyrë eksplicite në këtë dokument ose jepen si derogime nga **ZRrE**. Përveç paragrafit 3.1.1 dhe sipas kërkesës së përdoruesit të rrjetit, përjashtimi për **kriterin 'N-1'** mund të bëhet me kusht se ky përjashtim ndikon vetëm në sigurinë e furnizimit për këtë përdorues të sistemit dhe se ky përdorues i sistemit plotësisht pranon pasojat e përjashtimit. Këto përjashtime sipas kërkesës së përdoruesit të sistemit duhet të përmenden në mënyrë eksplicite në marrëveshjet e tyre për kyçje, përfshirë pranimin e pasojave nga përdoruesi i rrjetit.

3.1.2 Në rrethanat aktuale ka raste, përveç atyre të përmendura në paragrafin 3.1.1 kur **kriteri 'N-1'** nuk mund të përmbushet gjatë tërë kohës. Këto situata duhet të identifikohen dhe publikohen nga **OST** në **Planin zhvillimor të transmisionit** dhe të shpijnë qoftë në investime të cilat zbusin situatën ose të kërkohet derogim nga **ZRrE**.

3.2 Kriteret e Planifikimit – Sistemi 400 dhe 220 kV

3.2.1 Sistemi 400 dhe 220 kV

3.2.1.1 Kriteret e planifikimit të definuara në këtë seksion 3.2 aplikohen për të gjitha elementet e **Sistemit të transmisionit** të operuar në 400 dhe 220 kV përfshirë transformatorët ndërmjet nivelit 400 dhe 220 kV.

3.2.1.2 Transformatorët që vetëm lidhin rrjetin e nivelit 400 kV dhe 220 kV me rrjetet e nivelit më të ultë të tensionit, duhet të jenë në pajtueshmëri me kriteret e planifikimit të definuar në paragrafin 3.3.

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 8 nga 15</i>

3.2.2 Kriteret e planifikimit në kushtet normale të sistemit

3.2.2.1 Kriteret e planifikimit në këtë seksion 3.2.2 aplikohen për rrjetin e nivelit 400 dhe 220 kV në **kushtet normale të sistemit**.

3.2.2.2 Kriteret e planifikimit në këtë seksion 3.2.2 janë të aplikueshme për të gjithë skenarët e ngarkesës së parashikuar , gjenerimin dhe programet e importit dhe eksportit, që priten në **kushtet normale të sistemit**. **OST** duhet të kontrolloj kriteret për disa skenarë të cilët së bashku përfaqësojnë përdorimin e **sistemit të transmisionit** në vitin e planifikuar.

3.2.2.3 **Sistemi i transmisionit** 400 dhe 220 kV duhet të planifikohet në atë mënyrë që sistemi të mund të operohet edhe në rast të rënies së një elementi të sistemit në Kosovë ose në sistemet fqinje të interkoneksionit, si në vijim:


- (a) Linjë ose kablo nëntokësore e transmisionit, transformator ose ndonjë kompensator/reaktor i fuqisë reaktive;
- (b) Humbja e një **njësie gjeneruese** ose dështimi i furnizimit nga një furnizues i energjisë;

3.2.2.4 Në asnjë rast nuk duhet të ketë:

- (a) Jo stabilitet të sistemit i cili mund të shkaktoj ndalje të tërësishme dhe me përmasa të gjera;
- (b) Humbje të kapacitetit të furnizimit;
- (c) Mbingarkim i papranueshëm i pajisjeve;
- (d) Kufijtë e papranueshëm të tensionit ;
- (e) Ndryshimi i papranueshëm i shpejtë i tensionit;

3.2.3 Kriteret e planifikimit në kushtet e ndërprerjes së planifikuar

3.2.3.1 Kriteret e planifikimit në seksionin 3.2.3 aplikohen për rrjetin 400 dhe 220 kV nën **kushtet e ndërprerjes së planifikuar**.

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 9 nga 15</i>

3.2.3.2 Kriteret e planifikimit në këtë seksion 3.2.3 aplikohen për të gjitha ngarkesat e parashikuara, gjenerimin, programet e importit dhe eksportit të parashikuar në kushtet e ndërprerjes së planifikuar. **OST** duhet të kontrolloj kriteret për disa skenar të cilët së bashku paraqesin **sistemin e transmisionit** gjatë kushteve të ndërprerjes në vitin planifikues.

3.2.3.3 Sistemi 400 dhe 220 kV duhet të planifikohet në atë mënyrë që **kriteri 'N-1'** në kushtet e ndërprerjes së planifikuar të jetë i aplikueshëm. Kjo do të thotë të merren parasysh skenarët e ngarkesës së parashikuar, gjenerimit, programet e importit dhe eksportit, **sistemi i transmisionit** plotësisht duhet të përmbushë **kriterin 'N-1'** dhe përmbushë kërkesat e paragrafëve 3.2.2.3 dhe 3.2.2.4.


3.3 Kriteret e Planifikimit – Sistemi 110 kV

3.3.1 Sistemi 110 kV

3.3.1.1 Kriteret e planifikimit të definuara në këtë seksion 3.3 aplikohen për të gjitha elementet e **sistemit të transmisionit** të Kosovës të operuar në 110 kV dhe 220 kV përfshirë transformatorët ndërmjet 220 dhe 110 kV.

3.3.1.2 Për transformatorët të nënstacioneve ekzistuese 220 kV dhe 110 kV në të cilat kyçen në nivelet e tensioneve 35 kV dhe 10(20) kV dhe të cilat janë në pronësi të KOSTT, kriteri N-1 nuk do të mund të plotësohet për një periudë kohore të papërcaktuar¹, për shkak tekniko-ekonomike dhe nuk paraqet zgjidhjen teknike të pranueshme për shkak të koston së lartë. Për rastet e ndërprerjeve të planifikuara dhe te nënstacionet ku kriteri N-1 nuk plotësohet, harmonizimi do të bëhet me OSSH ashtu që ndërprerjet të planifikohen në perioda kur ngarkesa është e ulët. Për konsumator me rëndësi të veçantë në harmonizim me OSSH-në rezerva e përkohshme transformuese sigurohet nga kapacitetet e rrjetit të tensionit të mesëm. Aranzhimi i tillë nëse teknikisht është i mundshëm bëhet me ndërlidhje të rrjetit të tensionit të mesëm nga dy nënstacione të ndryshme me shfrytëzimin edhe të NS 35/10(20) kV (për tensione të ndryshme të TM)

¹ **ZRrE** përcakton kohën e derogimit të këtij kriteri

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>faqe 10 nga 15</i>

apo përmes linjave ajrore/kabllove (për tensione të njëjta të TM), të cilat në kushte normale shërbejnë si lidhje unazore rezervë.

3.3.2 Kriteret e planifikimit në kushtet normale të sistemit

3.3.2.1 Kriteret e planifikimit në këtë seksion 3.2.2 aplikohen për rrjetin 110 kV në **kushtet normale të sistemit**.

3.3.2.2 Kriteret e planifikimit në këtë seksion 3.2.2 janë të aplikueshme për ngarkesën e parashikuar dhe programin e gjenerimit për **kushtet normale të sistemit**. **OST** duhet të kontrolloj kriteret për disa skenar të cilët së bashku përfaqësojnë përdorimin e **sistemit të transmisionit** në vitin e planifikuar.


3.3.2.3 Sistemi i transmisionit 110 kV duhet të planifikohet në atë mënyrë që sistemi të mund të operohet në **kushtet normale të sistemit**, të ndonjë nga elementi si në vijim:

- (a) Linjë ose kablo nëntokësore e transmisionit, një transformator i tensionit 400/110 kV apo 220/110 kV ose kompensator i fuqisë reaktive;
- (b) Humbja e një **njësie gjeneruese** ose një furnizuesi të energjisë;

3.3.2.4 Në asnjë rast nuk duhet të ketë:

- (a) Humbje të kapacitetit të furnizimit;
- (b) Mbingarkim të papranueshëm të pajisjeve;
- (c) Kufijtë e papranueshëm të tensionit ;
- (d) Jo stabilitet të sistemit.

3.3.2.5 Si përjashtim nga seksioni 3.3.2.4 është pranuar se me rastin e rënies së pa planifikuar të një transformatori 110 kV të nënstacionit që nderlidhet me tensionin e mesëm dhe ku nuk plotësohet kriteri N-1, fuqia e cila përkohësisht dhe për kushte të ngarkesave të vogla që nuk mund të distribuohet mund të zgjasë sa koha optimale e kyçjes së rezervave (stand-by) transformuese apo transmetuese të rrjetit të OSSH-së, për kushte tjera varësisht llojit dhe përmasës së defektit deri në afatin e riparimit të tij.

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 11 nga 15</i>


3.3.3 Kriteret e Planifikimit në Kushtet e Ndërprerjes së Planifikuar

- 3.3.3.1 Kriteret e planifikimit në këtë seksion 3.3.3 aplikohen për rrjetin 110 kV nën kushtet e ndërprerjes së planifikuar.
- 3.3.3.2 Kriteret e planifikimit në këtë seksion 3.3.3 aplikohen për të gjitha ngarkesat e parashikuara në kushtet e ndërprerjes së planifikuar. **OST** duhet të kontrolloj kriteret për disa skenare të cilat së bashku përfaqësojnë përdorimin e **sistemit të transmisionit** gjatë ndërprerjeve të planifikuara në vitin planifikues.
- 3.3.3.3 Rrjeti 110 kV duhet të planifikohet në atë mënyrë që **kriteri ‘N-1’ nën kushtet e ndërprerjes së planifikuar** të jetë i aplikueshëm. Kjo do të thotë të merren parasysh ngarkesat e parashikuara, gjenerimi, programi i importit dhe eksportit, **sistemi i transmisionit** plotësisht duhet të përmbushë **kriterin ‘N-1’** dhe përmbushë kërkesat e paragrafëve 3.3.2.3 dhe 3.3.2.4.
- 3.3.3.4 Si përjashtim nga seksioni 3.3.3.3 është pranuar se pas një ngjarje të pa planifikuar gjatë kushteve të ndërprerjes së planifikuar, 80 MW² nuk janë distribuar gjatë kohës së restaurimit të ndërprerjes së planifikuar.

3.4 Pa-mundësia për të përmbushur Kriterin ‘N-1’

- 3.4.1.1 Pa-mundësia e **sistemit të transmisionit** për të përmbushur kriteret e definuara në seksionin 3.2 dhe 3.3 duhet të identifikohet nga **OST** dhe të raportohet në **Planin zhvillimor të transmisionit**. Në parim një pa-mundësi e tillë duhet të shpie në masat të cilat tërësisht eliminojnë këtë kufizim.
- 3.4.1.2 Nëse ekzistojnë faktet serioze se masat e përcaktuara në seksionin 3.4.1.1 janë efikase dhe se pa-mundësia për të përmbushur kriterin N-1 nuk mund të rezultoj në jo stabilitet të sistemit i cili do të mund të shkaktonte rënie totale, **ZRrE** mund t’i lejoj **OST** derogim për këte pa-mundësi .

² Nënstacionet 110/ x kV të ndërlidhura me dy linja 110 kV


	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>faqe 12 nga 15</i>

4 Planifikimi i nivelit të lidhjes së shkurtër në Sistemin e Transmisionit të Kosovës

- 4.1 Kriteret në këtë kapitull (4) aplikohen për tërë **sistemin e transmisionit** në kushtet normale të sistemit dhe në kushtet e ndërprerjes së planifikuar.
- 4.2 Kriteret në këtë kapitull (4) aplikohen për të gjitha ngarkesat e parashikuara, gjenerimit, programeve të importit dhe eksportit. **OST** do të kryej kalkulimet për planifikimin e lidhjes së shkurtër për disa skenar të cilët së bashku përfaqësojnë vlerat ekstreme sa i përket nivelit të lidhjes së shkurtër në vitin planifikues.
- 4.3 Cilado lidhje e shkurtër tre fazore ose lidhje e shkurtër e fazës me tokë në **Sistemin e Transmisionit** nuk duhet të tejkaloj vlerat nominale të lidhjes së shkurtër të cilësdo komponente në **sistemin e transmisionit**.
- 4.4 Në **Planin zhvillimor të transmisionit**, **OST** do të raportoj rrymat maksimale të lidhjes së shkurtër për secilin nënstacion në **sistemin e transmisionit** si rezultat i lidhjes së shkurtër tre fazore dhe lidhjes së shkurtër të fazës me tokë në të gjitha nyjet e **sistemit të transmisionit**.

5 Stabiliteti transient dhe dinamik i Sistemit të Transmisionit

- 5.1 Stabiliteti transient dhe dinamik i **sistemit të transmisionit** duhet të jetë i tillë që ngjarjet në **sistemin e transmisionit** dhe sistemin interkonektiv nuk shpijnë në jo stabilitet të **sistemit të transmisionit** dhe sistemit në interkoneksion.
- 5.2 Së bashku me operatorët e sistemit interkonektiv, **OST** duhet të studioj stabilitetin transient dhe dinamik të **sistemit të transmisionit**.
- 5.3 Nëse studimet e përmendura në paragrafin 5.2 shpijnë në konkluzionin që sistemi nuk është stabil, atëherë **OST** në bashkëpunim me operatorët e sistemit interkonektiv të duhet të ndërmarrin masa në mënyrë që të zgjidhin problemin e jo stabilitetit.

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>faqe 13 nga 15</i>

6 Kualiteti i tensionit në Sistemin e Transmisionit

6.1 Aplikohen standardet e kualitetit të tensionit siç janë përcaktuar në **Kodin e balancit të Kodit të Rrjetit**.

7 Kushtet e përgjithshme

7.1 Procedura e kontesteve

7.1.1 Kontestet që dalin nga aplikimi i këtyre standardeve të planifikimit të transmisionit duhet të trajtohen në pajtim me dispozitat e **Kodit të Rrjetit** dhe me **rregullën për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë** të miratuar nga **ZRrE** si mënyrë për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve në tregun e energjisë.

7.2 Ndryshimet në Standardet e sigurisë dhe planifikimit të Sistemit të Transmisionit


7.2.1 **Operatori i sistemit të transmisionit** është përgjegjës për administrimin e të gjitha kodeve teknike dhe standardeve relevante për energjinë elektrike, të cilat janë të kërkuara nën kushtet e licencës së vetë. Kjo përfshinë standardet e planifikimit të transmisionit, të cilat janë të kushtëzuara me miratimin e **ZRrE**-se para implementimit të tyre.

7.2.2 Ndryshimet e propozuara në këto standarde të planifikimit të transmisionit do të shqyrtohen nga **Komisioni për Qeverisjen e Kodeve Operacionale (KQKO)** që është themeluar në pajtim me procedurën e menaxhimit të kodeve teknike/operacionale të miratuar nga **ZRrE**. Ndryshimet e aprovuara nga **KQKO** dërgohen për aprovim në **ZRrE**.


7.2.3 **OST** duhet të marr përgjegjësinë për inkorporimin e çfarëdo ndryshimeve të cilat janë miratuar nga **ZRrE** dhe për publikimin e dokumentit të ndryshuar në web faqe.

7.3 Rrethanat e Paparashikuara

7.3.1 **OST** do të planifikoj **Sistemin e Transmisionit** në pajtim me këto standarde të planifikimit të transmisionit si dhe kodet e standardet tjera. Nëse në mënyrë të arsyeshme

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>faqe 14 nga 15</i>

paraqitet situata e cila nuk është parashikuar, atëherë **OST** do të veproj sipas dispozitave për rrethanat e paparashikuara të **Kodit të Rrjetit**.

	STANDARDET E SIGURISË DHE PLANIFIKIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	PO-KO-008
	<i>ver. 1.4</i>	<i>fajqe 15 nga 15</i>

8 Burimet dhe Dokumentet

9.1 Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1.	Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit
2.	
3.	
4.	

9.2 Dokumentet dhe formularët

9.3 Shënime për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.2	24.06.2008	Edicioni 1, Rishikimi 2	3 vjet
1.3	28.01.2011	Edicioni 1, Rishikimi 3	